

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI:

**“SHËRBIM MIRËMBAJTJE TË PAJISJEVE MJEKËSORE PËR NEVOJA TË SPITALIT
RAJONAL VJORË” NDARË NË LOTE:**

- **Loti 1:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Ekografisë GE/ Logiq F8 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 2:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Ekografisë ESAOTE/ MyLab 4 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 3:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Respirimit DRAGER/ Savina ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 4:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Makinave të Anestezisë SIARE/ PERSEO /DRAGER ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 5:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Endoskopisë të prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 6:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Laparoskopisë të prodhuesit ESSE3 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 7:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Artroskopisë të prodhuesit ARTHREX ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 8:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Tavolinës Operatore të UZUMÇU/ OM 6N ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 9:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Grafisë Portative PHILIPS/ Mobile Diagnost M50 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 10:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Mamografisë IMS GIOTTO/ Image 3DL ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.
- **Loti 11:** “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Grafisë Stacionare APELEM/ Carmague ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

- *Shërbime Mirëmbajtje dhe Riparimi: 50000000-5;*
- *Shërbime të ndryshme për Riparim dhe Mirëmbajtje: 50800000-3*

21,819,000 (njëzet e një milionë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë lekë) lekë pa TVSH ose **236,520.33** (dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet pike tridhjetë e tre) **euro pa TVSH.**

Loti 1: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Ekografisë GE/ Logiq F8 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit **2,241,200** (dy milionë e dyqind e dyzet e një mijë e dyqind lekë) **lekë pa TVSH** ose **24,294.85** (njëzet e katër mijë e dyqind e nëntëqind e katër pikë tetëdhjetë e pesë) **euro pa TVSH**.

Loti 2: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Ekografisë ESAOTE/ MyLab 4 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **618,000** (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **6,699.19** (gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëmbëdhjetë) **euro pa TVSH**.

Loti 3: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Aparatit të Respirimit DRAGER/ Savina ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **1,120,000** (një milion e njëqind e njëzet mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **12,140.92** (dymbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet pikë nëntëdhjetë e dy) **euro pa TVSH**.

Loti 4: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Makinave të Anestezisë SIARE/ PERSEO /DRAGER ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **1,640,000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **17,777.78** (shtëmbëdhjetë mijë e shtatë qind e shtatë dhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e tetë) **euro pa TVSH**.

Loti 5: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Endoskopisë të prodhuesit OLYMPUS ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **2,520,000** (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **27,317.07** (njëzet e shtatë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë pikë zero shtatë) **euro pa TVSH**.

Loti 6: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Laparoskopisë të prodhuesit ESSE3 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **3,445,000** (tre milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **37,344.17** (tridhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e katër pikë shtatëmbëdhjetë) **euro pa TVSH**.

Loti 7: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Kullës së Artroskopisë të prodhuesit ARTHREX ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **1,287,000** (një milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **13,951.22** (trembëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një njëzet e dy) **euro pa TVSH**.

Loti 8: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Tavolinës Operatore të UZUMÇU/ OM 6N ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **248,500** (dyqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind lekë) **lekë pa TVSH** ose **2,693.77** (dy mijë e gjashtëqind e nëntë dhjetë e tre pikë shtatëdhjetë shtatë) **euro pa TVSH**.

Loti 9: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Grafisë Portative PHILIPS/ Mobile Diagnost M50 ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **3,672,000** (tre milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë lekë) **lekë pa TVSH** ose **39,804.88** (tridhjetë e nëntëmijë e tetëqind e katër pikë tetëdhjetë e tetë) **euro pa TVSH**.

Loti 10: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Mamografisë IMS GIOTTO/ Image 3DL ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **3,777,800** (tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind lekë) **lekë pa TVSH** ose **40,951.76** (dyzet mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e gjashtë) **euro pa TVSH**.

Loti 11: “Shërbim riparim/mirëmbajtje të Grafisë Stacionare APELEM/ Carmague ose ekuivalent” për Spitalin Rajonal Vlorë” me fond limit: **1,249,500** (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind lekë) **lekë pa TVSH** ose **13,544.72** (trembëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e katër pikë shtatëdhjetë e dy) **euro pa TVSH**.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 27.08.2026 është 92.25 Lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

(E NJËJTË PËR GJITHA LOTET)

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 10.**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të

paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr.7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit limit që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **SSH UNI DIN EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent**, në përputhje e objektin e prokurimit e cila të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **SSH UNI DIN EN ISO 13485 për “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente** në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve

apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 13485 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore. Ky standard është i nevojshëm përse I përket sigurisë dhe efektivitetit të produkteve, duke përmbushur kërkesat rregullatore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë. Një ndër aspektet kryesore të ISO 13485 përfshin dhe Menaxhimin e riskut: Fokus në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore. Përputhshmëria rregullatore: Sigurimi që pajisjet mjekësore përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kontrolli i furnitorëve: Kërkesa për vlerësimin dhe monitorimin e furnitorëve për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

Gjithashtu këto kritere gjejnë mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 1 (një) Inxhinier Biomedikal/ Elektronik/ Mekatronik/ Informatik ose çdo arsim tjetër i ngjashëm / Specialist në stafin e vet të trajnuar për pajisjet mjekësore objekt prokurimi të cilët do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet:

- Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,
- Kontrata e punes e vlefshme ose Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore te muajit te fundit
- CV.

Shënim: Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e

objektit të kontratës.” dhe nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 4/b dhe 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose...”, bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Qëndrueshmëria e inxhinierëve në punë tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësit në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kriteri i mësipërm është vendosur në zbatim dhe të Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga prodhuesi** / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të jete origjinal ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Ky kriter është i përcaktuar në Ligj nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në zbatim të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, përsa i përket kërkesës për Autorizim për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, garanton mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi. Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore,” i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat kryesore për vendosjen në treg të pajisjeve mjekësore, procesin e regjistrimit, vlerësimin e konformitetit, mënyrën e shpërndarjes,

inspektimin dhe mbikëqyrjen e këtyre pajisjeve. Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Datë 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”.

- 2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër kryerjen e shërbimit ‘full risk’, mirëmbajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e çdo defekti/pjese të mundshme/gjatë periudhës së kontratës, për pajisjen dhe të gjithë aksesoret të cilat janë të lidhura me pajisjen, sipas specifikimeve teknike.
- 2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e AK-ve përfituese.
- 2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të përcaktojë më shumë se një person kontakti për raportimin e defekteve dhe çështjeve administrative, për të cilët duhet të bëjë me dije Autoritetin Kontraktor (telefon dhe email). Çdo ndryshim kontakti duhet të raportohet menjëherë me shkrim palëve. Stafi (i të Kontraktuarit) duhet të jetë i pajisur me kartë (mjet) identifikimi personal gjatë vizitave në ambientet e Kontraktuesit dhe të shoqërohet nga stafi teknik.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 36 “Specifikimet teknike” nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, rekomandimin e APP-së nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentat e tenderit të procedurave të prokurimit publik”, rekomandimin e APP-së dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr.145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi e punës i caktuar nga titullari e AK-së përfituese, bazuar në nevojat e të cilës, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor Përfitues.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë pjesë e pandarë e DST

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve dhe mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Transporti/montimi/zë dhe vendosja e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet nga operatori ekonomik fitues.

NJËSIA E PROKURIMIT